



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2019

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8331,
DATË 21.4.1998, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastet kur, pa shkaqe të përligjura, nuk ekzekuton vendimin në përputhje me përmbajtjen e tij, këtë ligj dhe akte të tjera ligjore në fuqi, prokurori mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 2

Në paragrafin e parë, të nenit 10, pas fjalës “ ... prokurorit” shtohen fjalët “ ... nga personat përgjegjës për ekzekutimin e vendimit ...”.

Neni 3

Neni 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 11
Gjykata

Për vendimet penale me ekzekutim të menjëhershëm, gjykata që ka dhënë vendimin ka detyrimin të urdhërojë menjëherë, pas shpalljes së tij, ekzekutimin e vendimit penal.”.

Neni 4

Neni 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 16 Detyrat e Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit është përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve të mëposhtme:

- a) Dënim me burgim për personat në gjendje të lirë;
- b) Dënimet plotësuese, parashikuar në pikat 2, 3, 7, 8, 10 e 11, të nenit 30, të Kodit Penal.

Policia e Shtetit, mbi bazën e urdhrit të prokurorit, në bashkëpunim me seksionet e Policisë Gjyqësore ose Policinë Ushtarake, kryen veprimet për ekzekutimin vullnetar të dënimit me burgim, në të kundërt, vepron forcërisht ndaj të dënuarit.

Policia e Shtetit, në bazë të një kërkesë ose me nismën e vet, mbështet veprimet e seksioneve të policisë gjyqësore, të policisë ushtarake, policisë së burgjeve dhe të organeve të tjera përkatëse, të ngarkuara, sipas këtij ligji, për ekzekutimin e vendimeve penale, që kanë marrë formë të prerë apo që kanë ekzekutim të menjëhershëm.”.

Neni 5

Në nenin 17 hiqen fjalët “... dënimet plotësuese të parashikuara në pikën 2, të nenit 30, të Kodit Penal, ...”.

Neni 6

Në nenin 20 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- a) Paragrafi i dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ I dënuari njofton prokurorin për ekzekutimin e publikimit të vendimit.”.

- b) Në fund të fjalisë së dytë, të paragrafit të dytë, pas fjalës “... ekzekutimit ...” shtohen fjalët “... si dhe në raste të veçanta kur e kërkon prokurori.”.

- c) Paragrafi i tretë shfuqizohet.

Neni 7

Në paragrafin e katërt, të nenit 21, fjalët “... sekuestrim si masë provizore kur jepet një dënim me konfiskim.” zëvendësohen me “... konfiskim pasurie kur më parë është vendosur sekuestrimi.”.

Neni 8

Në nenin 22 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në paragrafin e parë, fjalët "... menjëherë ose tërhiqen prej tij për vënien në ekzekutim ..." zëvendësohen me fjalët "... në formë të shkurtuar, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj ...".
- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.
- c) Në paragrafin e gjashtë, fjalët "... në institucione të veçanta ..." zëvendësohen me fjalët "... institucione mjekësore ...", dhe, në fund të kësaj fjalie, fjalët "... vepron sipas rezultateve..." zëvendësohen me fjalët "... kur ka arsye në bazë të rezultateve, i paraqet kërkesë gjykatës sipas parashikimeve ligjore."

Neni 9

Në fund të paragrafit të dytë, të nenit 26, fjalët "... ligjit "Për trajtimin e të dënuarve me burgim"." zëvendësohen me fjalët "... ligjit që rregullon trajtimin e të dënuarve me burgim apo të paraburgosurve."

Neni 10

Paragrafi i dytë, i nenit 29, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Shërbimi i Provës, në bazë të detyrimeve nga personi i dënuar, përcakton institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale, ku do të vendoset i dënuari në gjysmëliri."

Neni 11

Në nenin 31/4 bëhen këto ndryshime:

- a) Në paragrafin e parë, fjalët "... në shkronjën "a", të nenit 59 ..." zëvendësohen me "... në nenin 59/a ...".
- b) Në paragrafin e pestë, fjalët "... zyrës përkatëse vendore ..." zëvendësohen me fjalët "... degës territoriale ...".

Neni 12

Në nenin 31/6 bëhen këto ndryshime:

- a) Në fjalinë e dytë, të paragrafit të dytë, hiqen fjalët "... natyra e veprës penale të kryer ...".

b) Në paragrafin e tretë hiqet fjala “... prejardhjen ...”.

c) Në paragrafin e shtatë, fjalët “Zyra vendore...” dhe “... zyrës përkatëse vendore ...” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “Dega territoriale ...” dhe “... degës territoriale ...”.

Neni 13

Neni 31/7 shfuqizohet.

Neni 14

Neni 31/8 shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 31/9 bëhen këto shtesa:

- a) Në paragrafin e dytë, pas fjalës “... i burgosur ...” shtohen fjalët “... apo i paraburgosur ...”, si dhe mbas fjalës “... i dënuari...” shtohen fjalët “...apo i paraburgosuri...”.
- b) Në fund të paragrafit të gjashtë shtohen fjalët “... për një vepër tjetër penale.”.

Neni 16

Në nenin 31/10 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- a) Në fund të paragrafit të parë, fjalët “... të pjesshëm a të plotë të dënimit alternativ” zëvendësohen me fjalët “... e dënimit alternativ me një dënim alternativ tjetër ose me burgim.”.
- b) Në paragrafin e tretë, fjalët “... ndryshimin ose revokimin ...” zëvendësohen me fjalët “... revokimin dhe ndryshimin ...”, si dhe fjala “... alternative ...” ndryshohet me fjalën “... të mëparshme ...”.

Neni 17

Neni 31/12 shfuqizohet.

Neni 18

Paragrafi i tretë, i nenit 32, shfuqizohet.

Neni 19

Në fund të paragrafit të dytë, të nenit 33, fjalët "... me burgim sipas Kodit Penal" zëvendësohen me fjalët "... sipas përcaktimeve të nenit 34, të Kodit Penal."

Neni 20

Në paragrafin e parë, të nenit 34, fjalët "... dhe 9 ..." zëvendësohen me fjalët "... 9 dhe 10 ...".

Neni 21

Paragrafi i dytë, i nenit 39, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Kur i dënuari është shtetas i huaj ose person pa shtetësi, si dhe ka pasur dënim kryesor burgimin, Policia e Burgjeve ia dorëzon Policisë së Shtetit, e cila kryen procedurat për nxjerrjen jashtë territorit."

Neni 22

Në nenin 40 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në paragrafin e parë, fjalët "... nga organi përmbartimor kompetent, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për ekzekutimin e detyrueshëm." zëvendësohen me fjalët "... drejtpërdrejt nga organi i prokurorisë në bashkëpunim me Policinë e Shtetit ose organin kompetent shtetëror, sipas ligjit përkatës."
- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 23

Në nenin 41 bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në fund të paragrafit të parë, fjalët "... që e ka emëruar ose që ka lidhur marrëdhëniet e punës i dënuari, me largimin nga detyra përkatëse, duke respektuar rregullat ligjore përkatëse." zëvendësohen me fjalët "... që merr kërkesën për punësim ose organit që ka tagër ta emërojë, brenda afatit ndalues të dënimit plotësues të dhënë nga gjykata."
- b) Paragrafi i dytë shfuqizohet.

Neni 24

Në nenin 42, fjalët "... dokumentin për kohën e caktuar në vendimin e gjykatës ..." zëvendësohen me fjalët "... të drejtën e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo mjeshtërisë së caktuar ...".

Neni 25

Pas nenit 44 shtohen nenet 44/1 e 44/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 44/1

Heqja e së drejtës prindërore

Në ekzekutimin e këtij vendimi prokurori i vë në dispozicion urdhrin e ekzekutimit organeve të Policisë së Shtetit të vendbanimit ose vendqëndrimit të fëmijës, me qëllim mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit sipas vendimit të gjykatës.

Neni 44/2

Ndalimi i daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Në ekzekutimin e vendimit të ndalimit të daljes jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, prokurori i vë në dispozicion urdhrin e ekzekutimit Policisë së Shtetit, me qëllim mbikëqyrjen dhe kontrollin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës."

Neni 26

Në nenin 45 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në fund të paragrafit të parë, fjalët "... sipas përcaktimit që bën ministria mbi kërkesën e prokurorit." zëvendësohen me fjalët "... për subjekte që nuk mbajnë përgjegjësi penale për veprën e kryer."

b) Paragrafi i dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, dërgimi në institucion i personit që dyshohet se ka kryer një vepër penale, kryhet:

- a) nga autoriteti shëndetësor që e ka në trajtim;
- b) nga autoriteti shëndetësor, me ndihmën e Policisë së Shtetit, kur kërkohet nga mjekët që e kanë në trajtim;
- c) Në rast se i dyshuari i lirë nuk ekzekuton urdhrin vullnetarisht, shoqërimi për në institucionin mjekësor i specializuar kryhet nga Policia e Shtetit".

Neni 27

Në paragrafin e parë, të nenit 46, fjalët "... institucionet e posaçme të edukimit të të miturve." zëvendësohen me fjalët "... qendra/institucione publike ose private, të cilat janë të pajisura me infrastrukturën dhe personelin e duhur, për të përmbushur nevojat e veçanta të të miturit dhe të ekzekutimit të vendimit gjyqësor.".

Neni 28

Në nenin 47 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

- a) Në titullin e dispozitës, fjalët "Masat penale ..." zëvendësohen me fjalët "Dënimet kryesore...";
- b) Në paragrafin e parë, fjalët "... masë penale..." zëvendësohen me fjalët "... dënim me gjobë ...".

Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

"Kur gjykata ka vendosur mbarimin e personit juridik, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit:

- a) për shoqëritë tregtare, Qendrës Kombëtare të Biznesit, e cila bën çregjistrimin e saj;
- b) për organizatat jofitimprurëse, gjykatës që ka bërë regjistrimin, e cila bën çregjistrimin e saj.".

Neni 29

Pas nenit 47 shtohen nenet 47/1, 47/2, 47/3 e 47/4, me këtë përmbajtje:

"Neni 47/1

Dënimet plotësuese ndaj personave juridikë

Dënimet plotësuese ekzekutohen së bashku me dënimin kryesor.

Kur gjykata ka vendosur një dënim plotësues ndaj një personi juridik, një kopje e urdhrin të ekzekutimit dërgohet, si më poshtë vijon:

- a) Për shoqëritë tregtare, Qendrës Kombëtare të Biznesit, e cila bën publikimin në regjistër të vendimit në formë të shkurtuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Detyrimisht, të dhënat për vendimin pasqyrohen në ekstraktin e lëshuar nga QKB-ja lidhur me subjektin e dënuar;

- b) Për organizatat jofitimprurëse, gjykatës pranë së cilës është bërë regjistrimi i saj, e cila, për dënimet plotësuese, bën ndryshimet dhe shënimet përkatëse në regjistër.

Neni 47/2

Ekzekutimi i dënimeve jo me burgim për të miturit

1. Për ekzekutimin e vendimeve jo me burgim për të miturit, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës.
2. Për dënimin me kufizim lirie, punonjësi i Shërbimit të Provës kryen njoftimin në vendbanimin ose vendqëndrimin e të dënuarit të mitur. Për këtë qëllim, mban procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit të mitur personalisht ose mbrojtësit të të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Punonjësi i Shërbimit të Provës cakton kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.
3. Për dënimet e tjera plotësuese, Shërbimi i Provës vepron në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Neni 47/3

Ekzekutimi i dënimit me burgim për të mitur

1. Për ekzekutimin e vendimit të dënimit me burgim për të mitur, prokurori i dërgon urdhrin e ekzekutimit institucionit të paraburgimit, i cili merr masat për kalimin e të miturit në IEVP për të mitur.
2. Për të dënuarin e mitur, i cili ka qenë në gjendje të lirë ose në ngarkim të të cilit gjatë fazës së hetimit dhe gjykimit ka pasur një masë sigurimi të ndryshme nga masa e sigurimit “arrest në burg”, urdhri i ekzekutimit i dërgohet komisarit të policisë së vendbanimit ose vendqendrimit të të dënuarit të mitur. Për këtë qëllim, punonjësi i policisë mban procesverbal, i cili i dorëzohet të dënuarit të mitur personalisht ose mbrojtësit të të miturit ose përfaqësuesit të tij ligjor. Punonjësi i policisë cakton kohën dhe vendin e paraqitjes vullnetare, me paralajmërimin se, në rast të mosparaqitjes vullnetare, vendimi do të ekzekutohet në mënyrë të detyruar.

Neni 47/4

Ekzekutimi i dënimit me gjobë për të miturin

1. Ekzekutimi i një vendimi dënim me gjobë për të miturin bëhet me urdhrin e ekzekutimit të prokurorit në masën, afatet dhe mënyrën e pagimit, sipas vendimit të gjykatës.

2. Ekzekutimi bëhet nga organi përmbartimor në territorin e të cilit ka vendbanimin i dënuari i mitur, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile për titujt ekzekutivë.”.

Neni 30

Në nenin 48 bëhen këtë ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe që nuk janë ankuar, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të shkurtuar brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë.”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 3, pas fjalës “... vendimet ...” shtohet fjala “... e shkurtuara ...” dhe pas fjalës “... dënime ...” shtohet fjala “... të tjera...”.

4. Pas pikës 4 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Për vendimet ndaj personave juridikë, gjykata i dërgon prokurorit, brenda 5 (pesë) ditëve, vendimin e shkurtuar”.

Neni 31

Në nenin 49 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në fjalinë e parë fjalët “... dhe lëshon ...” zëvendësohen me fjalët “... për të cilën lëshon dhe dërgon ...”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Për dënimet ndaj personave juridikë urdhri i ekzekutimit nxirret brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e shkurtimit të vendimit.”

Neni 32

Pas paragrafit të dytë, të nenit 50, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Urdhri i ekzekutimit për vendimet penale ndaj personave juridikë ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.”.

Neni 33

Në fund të fjalisë së dytë, të paragrafit të parë, të nenit 52, fjalët "... tjetër, autorizohet prej tij prokurori përkatës." zëvendësohen me. "... të ndryshëm nga ai i gjykatës që ka dhënë vendimin, kompetent për kontrollin procedural është prokurori i rrethit ku kryhet ekzekutimi."

Neni 34

Në pikën 2, të nenit 53, fjalët "... mbrojtësit të tij" zëvendësohen me fjalët "... mbrojtësve të tyre".

Neni 35

Në paragrafin e parë, të nenit 54, fjalët "... nga personi zyrtar i pranishëm, i cili ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij" zëvendësohen me "... prej tij. Personi zyrtar i pranishëm ka të drejtë të pasqyrojë pretendimet e tij."

Neni 36

Në nenin 56, pas fjalës "... prokurori ..." shtohen fjalët "... fillon ndjekje penale, ose ...".

Neni 37

Në paragrafin e parë, të nenit 65, pas fjalëve "Prokurori i Përgjithshëm ..." shtohen fjalët "... , drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ministri i ...".

Neni 38

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI